



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
KOMISIONI I DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT

Nr. 106 Prot.

Tiranë, më 20.08 2024

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, të kreut I, nenit 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me Urdhrin nr. 21, datë 06. 02. 2023, të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, i ndryshuar, me urdhërin nr. 56, datë 23.03.2023 “Për një ndryshim në Urdhërin nr. 21, datë 06.02.2023 “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr 26 datë 20.08 .2024 si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Dibër, Dosje pune dhe personale nr. 2366, “Kritiku”, në ngarkim të Xh. M., me 114 (njëqind e katërmëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1974-1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.
2. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, Proçesverbal asgjësimi nr. 18, datë 26.05.1982, në ngarkim të L. Ç., me 1 (një) fletë. Dokumenti daton në vitin 1982. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Sekret”.
3. Arkiva e Autoritetit, Fondi të Arratisur, Fashikull nr. 2803, në ngarkim të R. A., me 145 (njëqind e dyzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1946-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.
4. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Elbasan, Dosje formulare nr. 6502, në ngarkim të B. B., me 3 volume, në total me 780 (shtatëqind e tetëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1961-1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.
5. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Krujë, Dosje agjenturore nr. 1735, “Paraziti” në ngarkim të F. D., me 40 (dyzet) fletë. Dosja daton në vitet 1982-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

6. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Krujë, Dosje formulare nr. 1731, në ngarkim të F. D., me 128 (njëqind e njëzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1982-1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.
7. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, Dosje pune nr. 899, “Rozmaria” në ngarkim të E. K., me 184 (njëqind e tetëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1965-1974. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.
8. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Ersekë, Dosje pune dhe personale nr. 456, “Benzinati” në ngarkim të Z. H., me 282 (dyqind e tetëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1958-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

- Mbështetur në nenin 44, pika 4 të ligjit 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në Vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.01.2023, pika 1 e dispozitivit.
2. Ngarkohet Sekretari i KDZH, të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.
 3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar, t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.
 4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuar në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I KDZH

Dr. Gentiana Sula

